

V E N D I M
Nr. 49, datë 26.7.1999

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““

më datë 26.7.1999, mori në shqyrtim paraprak kërkesën me nr.53 Akti që i përket :

KËRKUES: BAJAZIT BECI

OBJEKTI: Papajtueshmëria me Kushtetutën e dekretit nr.2318, datë 19.2.1999 të Presidentit të Republikës.

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën,

V Ë R E N:

Kërkuesi ka parashtruar para kësaj Gjykate që t'i garantohet zbatimi i Kushtetutës për gjykimin e padisë të paraqitur në Gjykatën e Lartë, pasi kjo e fundit me qëndrimin e mbajtur i ka krijuar bindjen se nuk do ta shqyrtojë atë, megjithëse mundësitë ligjore për shqyrtimin e saj ekzistojnë.

Sipas nenit 131/c të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese shqyrton kërkesat për papajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore me Kushtetutën, por në këto raste ajo mund të vihet në lëvizje nga organet e përcaktuara në nenin 134 të Kushtetutës dhe jo nga individët. Këta të fundit mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese vetëm kur u shkelen të drejtat e tyre kushtetuese nga një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

Në këto kushte kërkuesi nuk legjitimohet për ngritjen e kësaj kërke.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 38 të Ligjit nr.8373, datë 15.7.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Tiranë, më 26.7.1999

Nr. 52 i regjistrimit themeltar

Nr. 49 i Vendimit.